



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:217298

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527492

P.nr.427/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me praktikanten e rregullt të kësaj gjykate Leonita SADIKU, në çështjen penale kundër të pandehurit I...H..... nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.580/2023 (2023:217298) të datës 16.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 28.03.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri I...H..... dhe të dëmtuarës M.... P....., me datë 29.03.2024 mori dhe publikisht shpalli dhe të njëjtën ditë e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I...H....., nga i ati N..., e ëma Z..., e vajzërisë Z..., i lindur me 17.09.1993 në Mitrovicë, me vendbanim në rrugën “Sh.... H....”, fshati F... i M..., Mitrovicë, i martuar, baba i dy fëmije, punon si mjeshtër i qeramikës, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 13.04.2023, rreth orës 18:40, në rrugën “D.... V....”, në Suhodoll në drejtim të lagjes T...., i pandehuri me dashje e vë në vëzhgim të vazhdueshëm dhe komunikon me qëllim të ngacmimit të dëmtuarën M.... P..., në atë mënyrë që derisa e dëmtuara ishte në rrugë duke shkuar në punë, i pandehuri me veturën B7, ngjyrë hiri, me targa, i ndalet para këmbëve dhe ju drejtohet me fjalë “*a po e sheh se të zura prapë*” pastaj vazhdon ta ndjekë me veturë duke vazhduar t’i flasë vazhdimisht dhe në një moment zbret nga automjeti duke vazhduar në drejtim të saj, por pasi kupton që e ka lajmëruar policinë menjëherë largohet nga aty, me të cilat veprime e dëmtuara e vë nën shqetësim të madh emocional.

Me këtë ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69 ,70, 79 e lidhur me nenin 182 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË- në shumën prej 300.00 (me fjalë: *treqind*) euro, të cilën dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t`ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar.
- II. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. E dëmtuara M..... P....., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike në këtë çështje penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr. 580/2023 të datës 16.10.2023, kundër të pandehurit I...H....., për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 28.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri I...H....., dhe e dëmtuara M..... P.....

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh shkalla e përgjegjësisë penale, intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

E dëmtuara në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit i datës 13.04.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarës M.... P.... i datës 13.04.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje i dëshmitarit A... P.... i datës 15.04.2023 Procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit I..H....., i datës 15.04.2023 dhe , Raporti informues i policit hetues Rrustem Mehmeti #4709, i datës 13.04.2023 dhe Raporti i oficerit Arta Haziri #11319, me numër 2023-BC-390 i datës 13.07.2023.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Ngacmim nga neni 182 paragrafi.1 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rënduese në këtë rast, gjykata nuk ka gjetur, ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, kërkim faljen e shprehur në gjykatë ndaj të dëmtuarës dhe premtimin e bërë se më nuk do të përsërisë veprime të tilla.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit

nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen e pandehura të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, e dëmtuara, në seancën e shqyrtimit fillestar, ka hequr dorë nga parashtrimi i kësaj kërkesë.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.427/2023, datë 29.03.2024

Zyrtarja ligjore
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.